



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:262490

Datë: 11.08.2021

Numri i dokumentit: 02078286

AA.nr.483/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “D...” Sh.p.k, me seli në ..., Komuna e Lipjanit, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2892/2018, të datës 25.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “D...” Sh.p.k, me seli në, Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2892/2018, i datës 25.03.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2892/2018, të datës 25.03.2021, nën pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “D...” Sh.p.k, me seli në ..., Komuna e Lipjanit, me pronar Enver Morina, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit me numër IP nr.327/2018 të datës 27.07.2018, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës në Prishtinë. Ndërsa nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat F.G., nga Prishtina, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që Gjykata

e Apelit ta aprovojë ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ose të njëjtin ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës në Prishtinë, me vendimin nr.327/2018 të datës 27.07.2018, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e palës në procedurë "D..." sh.p.k, me seli në, KK Lipjan, me pronar E.M., të cilin e përfaqëson av. F.G., nga Prishtina, Rr. ".....",, dhe e ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr.17/2008 të datës 11.05.2018.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektoratit të Punës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me dt.10.12.2018, me pretendim se i njëjti është i pa bazë dhe jo i ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit me nr.327/2018 të datës 27.07.2018, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pabazuar, duke i'u referuar dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe neneve 6, 13, 20 dhe 23 të Ligjit nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë. Me arsyetim se gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, dhe drejtë ka zbatuar ligjin material kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e inspektorëve të punës. Andaj, për këto arsye gjykata thënie e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë e shqyrtimit kryesor si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e fakteve dhe provave, duke nxjerrë aktgjykim në kundërshtim me gjendjen faktike rreth aksidentit të ndodhur. Pastaj se, paditësi nuk e ka mohuar aksidentin e ndodhur, por ka paraqitur pretendime se ky aksident ka ardhur si rezultat i pakujdesisë së të dëmtuarit A.D., e që në rastin konkret inspektori i punës fare nuk i ka analizuar dhe shqyrtuar shkaqet dhe faktorët të cilët kanë shpie deri tek aksidenti në të cilin i dëmtuari ka pësuar lëndime. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase nga provat e administruara, e veçanërisht nga raporti zyrtar i inspektimit nr.01949 i datës 25.04.2018, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se qëndron arsytimi i të paditurës si në vendimin e kontestuar, se paditësi është përfshirë me shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore, dhe nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për eliminimin e tyre në afatin ligjor. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe Ligjit nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë, dhe se e paditura në mënyrë të drejtë ka vendosur kur paditësit i ka shqiptuar gjobot e cekura si në vendimin e datës 10.05.2018, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2011 për Përcaktimin dhe Shqiptimin e Gjobjave për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës. Sepse me nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës përcaktohet se *“1. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeç. 4 2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor. 3. Asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. 4. Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin t’ajajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme. 5. Sistemimi i punëve të lehta dhe të ndaluara nga paragrafi 2. i këtij neni për personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Ndërsa me nenin 6 të Ligjit nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë, është përcaktuar se “1. Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës. 2. Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike. 3. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësive objektive të së drejtës së detyrimeve”. Me nenin 13 par.1 pika 1.1 të të njëjti Ligj është përcaktuar se “1. Për garantimin e zbatimit të masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, punëdhënësi është i detyruar që të: 1.1. mbikëqyrë punën dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve të personave ose të shërbimeve të jashtme të kontraktuara prej tij për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Me nenin 20 të njëjtit Ligj është përcaktuar se “1. Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si: 1.1. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës; 1.2. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës; 1.3. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës; 1.4. në rast të përdorimit të teknologjisë së re; 1.5. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme. 2. Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij. 3. Përfaqësuesit e punëtorëve me rol specifik për sigurinë dhe*

shëndetin në punë do të kenë të drejtë të vijojnë trajnime adekuate. 4. Trajnimi i referuar në paragrafin 1. të këtij neni organizohet gjatë orarit të punës”. Kurse me nenin 23 të të njëjtit Ligj është përcaktuar se “1. Në rastet kur ka ndodhur aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës”. Prandaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka refuzuar si të pa bazuara pretendimet e paditësit të dhëna në padi, për faktin se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin mundur që të ndikonin që gjykata të mund të vërtetojë një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë përveç shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, ka dështuar në plotni në vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, pasi që kjo gjykatë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë të fakteve dhe provave të prezantuara nga paditësi. Kolegji i kësaj gjykate konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, nga arsyeja se nuk janë të argumentuara me asnjë provë, dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.483/2021, me datë 27.07.2021

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi